



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

VETËVLERËSIMI I NJOHURIVE

TESTI GJUHË SHQIPE

UDHËZIM PËR PUNË

- Testi që do të zgjidhni do t'ju ndihmojë të vlerësoni sa keni zotëruar materialin e mësuar.
- Testi përmban **20** detyra të cilat duhet t'i zgjidhësh për **60** minuta.
- Secilën detyrë lexoje me kujdes, mendo mirë se çfarë kërkohet në detyrë dhe për mënyrën sipas së cilës duhet ta zgjidhësh (duke e rrethuar, bashkuar, nënvizuar, plotësuar e të tjera).
- Shkruaj shkronjat qartë, duke pasur parasysh që përgjigjet e tua të jenë të kuptueshme, por edhe të sakta në kuptimin gramatikor dhe drejtshkrimor.
- Me rastin e zgjidhjes së detyrave në të cilat prej teje pritet që të plotësosh ndonjë gjë, gjithnjë duhet t'i përdorësh emërtimet e plota; shkurtesat nuk lejohen (psh., duhet të shkruhen emrat, e jo em. ose kallëzorja e jo kall., dhe të ngjashme).

Të dëshirojmë sukses në punë!

* Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено умножавати нити јавно објављивати без претходне сагласности Завода за вредновање квалитета образовања и васпитања.

1. Lexo vargjet e dhëna dhe trego llojin e tekstit.

Dhimbjet e zemrës së largët

E dashura ime i harroji fjalët

Si të mos ishin kurrë...

U dashurua me heshtjen

Një mollë e kuqe-gjak si faqja e jote

Midis shpatullave më ra

Asnjë plumb ska me më dhimtë

Më shumë

Në vdeksha pa të parë

Agim Spahiu

Ngjyros rrethin para përgjigje së saktë.

tekst letrar

tekst jo letrar

2. Lexo me kujdes tekstin e dhënë dhe trego ç`lloj teksti është?

Uji është një pjesë përbërëse e planetit tonë. Ai është një substancë pa erë dhe pa shije, qe mbulon rreth tri të katërtat e sipërfaqes së tokës...

Dy përqind e ujit të tokës është në formë të mirë, porse mbetet vetëm 1% e krejt ujit të tokës i përshtatshëm për përdorim nga njerëzit dhe kafshët. Ky ujë është kryesisht i liqeneve, lumenjve dhe i burimeve të ndryshme në tokë.

Një sasi e vogël e ujit ndodhet vazhdimisht në atmosferë, në trajtë avulli

Teksti i dhënë është tekst:

Letrar;

Informativ;

Joletrar;

Shkencor.

Ngjyros rrethët para përgjigjeve të sakta.

3. Më poshtë janë dhënë dy tekste mbi ndotjen e ambientit. Detyra juaj është të dalloni, se cili tekst paraqet shqetësim më të madh të qytetarëve?

a) Para një muaji është berë një anketë me qytetarët e komunës mbi problemet e shëndetësisë. Eshtë konstatuar se 60% të qytetarëve nuk kanë njohuri rreth ndotjes së ambientit ndërsa numri më i vogël i qytetarëve i dijnë pasojat, por nuk kanë mundësi të ndryshojnë gjendjen.

b) Numër i madh i qytetarëve kanë deklaruar se jetojnë në një vend dhe me një ambient, ku ndotja është në një shkallë mjaft të lartë. Pakënaqesitë dhe shqetësimet e tyre i kanë paraqitur shumë herë, por rreth këtyre problemeve-thuase nuk jep llogari askush. Shqetësimet e tyre për çdo ditë po rriten dhe vërehet një eskalim i tyre. Përkundër ankesave të qytetarëve, pushtetarët nuk po gjejnë kohë që të mirren me këtë problematikë, thua se asgjë nuk po ndodhë.

Tekst i cili paraqet shqetësim më të madh është:

- Teksti a);
- Teksti b).

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

4. Fjalitë e poshtëshënuar janë shkruar gabim, andaj detyrë e juaja është që fjalitë e tilla t' i shkruani në mënyrë të drejt dhe me kuptim.

- Vajza shaminë mirë lidhi, të bardhë pas kokës.
- Ja dëgjoj akoma zërin e mbytur, që i gurgullonte në kraharorin e tij tepër të gjerë.
- Frutat që i morëm nuk kenë me shije.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë

5. Lexo me kujdes tekstin e poshtëshënuar dhe trego se cila gjuhë është përdorur?

- Nona klithi. Unë që po i shkojsha bisht pas, nuk më doli as zoni nga frika. Gjyshja hyri me nxitim në dhomën tonë. Ajo sikur u qetsue nga ajo që pa në shtrat.

- Dil përjashta, - I tha nonës, - Jepi djalit ujë që ti kalojë frika.

- Nona m'dha ujë dhe piu edhe vetë.

Gjyshja mbeti të merrej me gjarpërin, kurse ne tham:nuk ka ma trime se gjyshja...

- Tekst formal
- Tekst joformal
- Tekst i informativ

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

6. Lexo dy tekstet e poshtëshënuara dhe trego cili tekst është shkencor?

a) Mesnatë në Henë

Nuk kishte erë, që ta largonte mesazhin. Nuk kishte shi që të binte mbi të.

- Doja të mbetej atje përgjithmonë, derisa dikush ta lëvizte. Duke menduar rreth fjalës përgjithmonë, Xheku mbeti si i shushatur. Ai tundi kokën për të hequr mendimet, pastaj u kujtua për kohën.

- Sa do të doja të kisha një orë dore, - tha ai, duke u ngritur në këmbë. Mund ta kapërcejnë kufirin kohor pa kuptuar.

b) Ajri

Toka është e mbështjellë nga një shtresë ajri afër 500 km e trashë që quhet atmosferë. Ajo i ndalon rrezet e rrezikshme të Diellit, që të djegin mbi Tokë. Ne nuk mund ta shohim ajrin, por e ndiejmë atë si erën. Ai përbëhet prej mjaft gazrash, si oksigjeni, të cilin e thithin gjatë frymarrjes dhe dioksidit të karbonit, që e nxjerrin.

Teksti a)

Teksti b)

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

7. Fjalia e dhënë i takon llojit të fjalive të thjeshta sipas kumtimit.

Pranvera erdhi e bukur si ngaherë.

Fjalia e dhënë është:

Pyetëse;

Dëftore;

Nxitëse;

Dëshirore.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

8. Në fjalinë e poshtëshënuar:

p.sh. Puna e bën njeriun njeri.

Fjala punë është:

Ndajfolje

Folje

emër

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

9. Vështro fjalët e dhëna dhe trego se çfarë janë për nga aspekti i formimit.

fshatar; malësor; fierak; tiranas; shkodran; gjirokastrite.

Fjalët e dhëna janë:

- Fjalë të thjeshta;
- Të prejardhura;
- Të përbëra.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

10. Trego sa ku bie theksi në fjalët e poshtëshënuar

- letërsi
- molla
- barium

Theksi në fjalët e dhëna bie:

- Në rrokjen e fundit;
- Në rrokjen e parafundit;
- Në rrokjen paraparafundit.

11. Janë dhënë dy grupe fjalësh. Detyra jote është të përcaktosh se në cilin grup janë fjalët që kanë diftongun «ua»?

Fjalët që kanë diftongun «ua» janë në grupin:

- Dielli; punoftë; vëllai;
- lexuat; duar; luan;

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

12. Janë dhënë tri fjalës.

asnjëherë, anakënd, kurdoherë

Ju duhet t`i dalloni nëse janë:

- fjalë e prejardhura
- fjalë e përbëra
- fjalë e përngjitura

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

13. Trego prej sa rrokjesh janë fjalët e poshtëshënuara?

këngëtari

babadimri

Fjalët e dhëna janë prej:

- Dy rrokjesh;
- Tri rrokjesh;
- Katër rrokjesh.
- Katër e më tepër rrokjesh.

14. Emrat dhe foljet e poshtëshënuara në cilin numër dhe, emrat në ç` gjini janë dhënë?

- dash
- plak
- mashkull
- marr
- vras
- rrëshqas
- bërtas

- Në numrin njëjës;
- Në numrin shumës.
- Në gjininë mashkullore;
- Në gjininë femërore; dhe
- Në gjininë asnjënjës.

Ngjyros rrathët para përgjigjeve të sakta.

15. Lexo me kujdes tekstin e poshtëshënuar dhe rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- Xhuxhi:Përshendetje, e dashur mbretëresh, ashtu siç kishim rënë dakrod, kam ardhur të marr princin tënd.

- Marta; - Oh, jo! Oh, jo!

- Xhuxhi; - Oh, po! Oh, po!

- Marta: - Xhuxh, të lutem, merr çdo gjë që dëshiron, por tim bir jo!

- Xhuxhi; - Jo dhe jo! Dua princin e vogël...

- Marta; - Oh, për gjënë që ke më të shtrenjtën mos më ler në ankth.

Teksti është dhënë në formë të:

- Dialogut;
- Monologut;
- Prologut.

16. Teksti i dhënë paraqet karakteristikat e veprës „Andrra e jetës”.

- Në veprën letrare me elemente filozofike, ku shfaqen tiparet dhe karakteristikat e autorit, kuptojmë motivet nga jeta e vështirë e fshatarëve të varfër.

- Në qendër të vëmendjes është një familje e varfër malësore që përbëhet nga nëna dhe dy vajzat.

- Vepra ndahet në tri pjesë që i përgjigjet fatit të tri heroinave: Trinës, Zogës e Lokes.

Autor i kësaj vepre është:

Andon Z. Çajupi;

Naim Frashëri;

Ndre Mjedja;

Ali Asllani.

Rretho rrethin para përgjigjes së saktë.

17. Lexo tekstin e poshtëshënuar, dallo llojin e poezisë.

Çou Rexho

Çou mare Rexho dil te lama

Dasëm të madhe po të ban nana

Çou Rexho djalo

Çou ma i miri nanës o

Se s'ka nana tjetër o

.....

Po vin krushqit rrethit malit

Rexha i vdekun në grazhd të kalit

Çou Rexho çou djalo se ma fike deren o...

.....

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Kënga kreshnike;

Poemë;

Baladë popullore.

18. Lexo tekstin e poshtëshënuar dallo se çfarë teksti është?

Alpet Shqiptare

- Udhëtimi ynë ndalet në një tjetër vend turistik që ia vlen të vizitohet jo vetëm nga turistët.
- Alpet Shqiptare të pozicionuara në anën veriperëndimore të Luginës së Drinit, fshihen midis dy bjeshkëve të larta, ku ndërthuren kontraste të papara.
- Aty përballen e bukura dhe e vështira, madhështia dhe ashpërsia. Përveç vlerave të pafundme natyrore, Alpet...

- Ditar;
- Reportazh;
- Udhëpërshkrim.

19. Lexo tekstin e poshtëshënuar dhe përcakto figurën stilistike.

Kush të fali bukurinë

Kush ta fali bukurinë

Që të më tregosh të zinë!

Kur të pashë për të vluar,

Pëllumbeshë pendë – shkruar,

Bubu!plumb në krahëruar

Plumb që vret duke gjëmuar!

.....

Leshrave t'ju binte hija

Yll i ndezur me shkëndia,

Ndezur mun në mes në ballë,

të më vesh në dhe të gjallë

Lasgush Poradeci

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë:

- Personifikimi;
- Metafora;
- Hiperbola

20. Mbramja
(Esad Mekuli)

Si tufa mëndafshi t'artë në të kaltrën shami,
N'mes dy duersh t'bardha, dy kodra nën borë.
Flakëron perëndimi. Retë mbi krye prorë
Ngasin nëpër qiell dhe zhduken n'hapsi.

Dhe drita e mbrame shuhet mbi cdo sukë;
Cipa e natës shkrihet mbi fusha t'përhime.
Malet heshtin nërrsi si me qenë të ngrime,
Si të humbetë jeta cdo gja, u nxi, u zhdukë.

Vargjet e shkëputura nga poezia e lartshënuar janë:

- Poemë;
- vargu i lirë;
- të rimuar;

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

